



SHPALLJE PËR FURNIZIME DHE SHËRBIME

AKP e cila ka në Administrim të Drejtpërdrejtë Ndërmarrjen Shoqërore “Inex Sharr Planina ” Brezovicë
SHPALLË këtë:

FTESË PËR OFERTË

I. LËNDA E KONTRATËS

Shpallje publike për furnizimin me derivate të tipit - dizell

Me qëllim të furnizimit me derivate te Qendra e skijimit në Brezovicë, AKP shpall tenderin për furnizim me derivate te tipit dizell

SHPALLJA PUBLIKE PËR FURNIZIM ME NAFTË

Për nevoja të mirëmbajtjes së pajisjeve dhe ngrohjes ne qendrën e skijimit ne Brezovice ndërmarrja ka nevojë për furnizim me naftë e tipit dizell.

Sasia e derivatit te naftës e tipit dizell është 10000 litra.

Kërkesat teknike për operatorin ekonomik:

Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar në Republikën e Kosovës

Duhet të ketë përvojë në furnizime dhe shërbime të ngjashme – Referencat.

Periudha për kryerjen e këtyre furnizimeve dhe shërbimeve më së largu 15 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Operatori ekonomik fitues do të shpallet ai i cili i plotëson kriteret teknike dhe oferton me çmimin më të ulët.

Buxheti maksimal i lejuar për këtë aktivitet është 20,000.00 Euro.

AFATI KOHOR DHE VENDI PËR DORËZIMIN E OFERTAVE

Për tu njohur më afër me aktivitetet që do të kryhen Operatorët ekonomik mund të bëjnë vizitë te Qendra e Skijimit në Brezovicë çdo ditë punë nga data 12.10.2023 deri më 22.10.2023.

Ofertat finale të cilat duhet të jenë në zarf të mbyllur, duhet të dërgohen më datën **23.10.2023** nga ora **13:15** deri në orën **14:15** në adresën e mëposhtme:

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. Dritan Hoxha nr. 55, 10000 Prishtinë.

Ofertat do të hapen me datën **23.10.2023** në ora **14:20** në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, rr. Dritan Hoxha nr. 55, 10000 - Prishtinë .

V. Përfaqësuesit legjitim të ofertuesve, mund të marrin pjesë me rastin e hapjes së ofertave.